

VENDIM
Nr.267, datë 19.6.1997

**PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSAT DOGANORE DHE TATIMI MBI VLERËN E
SHTUAR TË MAKINERIVE, PAJISJEVE DHE MATERIALEVE TË NEVOJSHME PËR
MONTIMIN E TYRE, QË IMPORTOHEN PËR T'U INVESTUAR**

Në mbështetje të nenit 2 të ligjit nr.8211, datë 23.4.1997 "Për përjashtimin e përkohshëm nga taksat doganore dhe TVSH-ja të disa importeve", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përjashtohen nga taksat doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar të gjitha makineritë, pajisjet dhe materialet e nevojshme për montimin e tyre, që importohen për t'u investuar në një nga veprimtaritë e përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi. Importimi bëhet nga vetë investitori ose nëpërmjet ndonjë sipërmarrësi. Investitori duhet të jetë person juridik i regjistruar në Shqipëri.

2. Do të përfitojnë lehtësitë e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi vetëm makineritë dhe pajisjet që i takojnë linjës teknologjike apo që lidhen drejtpërsëdrejti me procesin teknologjik përkatës.

3. Për qëllime vetëm të zbatimit të dispozitave të këtij vendimi:

a) Me fjalën "makinë" do të kuptohet çdo konstruksion i krijuar prej njeriut që, duke marrë energji në një formë të përshtatshme, si dhe instruksionet e duhura, është në gjendje të kryejë punë në kuptimin më të gjerë të fjalës. Një sistem makinash të lidhura sipas ndonjë skeme të përcaktuar përbëjnë atë që quhet makineri;

b) Me shprehjen "linjë teknologjike" do të kuptohet tërësia e makinerive dhe pajisjeve që do të nevojiten për të realizuar procesin teknologjik në fushën përkatëse ku do të bëhet investimi;

c) Me shprehjen "proces teknologjik" do të kuptohet tërësia e mënyrave dhe metodave që duhet të ndiqen hap pas hapi për të bërë të mundur kryerjen e qëllimit, për të cilën bëhet investimi përkatës;

d) Me fjalën "pajisje" do të kuptohen pajisjet dhe aparaturat që shërbejnë si plotësues të makinerive dhe që ndihmojnë për funksionimin normal të tyre, si dhe për matjen dhe kontrollin e parametrave të punës;

e) Me shprehjen "materiale të nevojshme për montimin e makinerive dhe pajisjeve" do të kuptohen të gjitha materialet e tilla, si kablllo, tubacione, rakorderi, termoizolues, dado e bulona, elektroda saldimi, shirita izolues elektrikë, ngjitës, bojëra llak e të tjera si këto, të cilat importohen në sasi të arsyeshme për t'u trupëzuar në linjën teknologjike. Nuk do të përfshihen në këtë përcaktim materialet e nevojshme për ndërtimin a përgatitjen e mjediseve ose bazamenteve ku do të montohen makineritë dhe pajisjet që përbëjnë linjën teknologjike.

4. Investimet që përfitojnë nga lehtësitë e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, janë:

a) në prodhim, me të cilin do të kuptohet instalimi i makinerive, pajisjeve dhe linjave teknologjike për të realizuar shfrytëzimin e pasurive natyrore, rritjen e bimëve dhe të kafshëve dhe përpunimin industrial të lëndëve të para;

b) në ndërtim, me të cilin do të kuptohet ngritja e parkut të makinerive dhe pajisjeve të nevojshme për të realizuar sipërmarrje ndërtimore;

c) në shërbimet në telekomunikacion, me të cilat do të kuptohet instalimi i centraleve, sistemeve të antenave dhe linjave dhe aparaturave të nevojshme për të realizuar telekomunikim masiv;

d) në shërbimet bankare, me të cilat do të kuptohet instalimi i rrjeteve kompjuterike dhe sistemeve të sigurisë;

e) në shërbimet e natyrës komunale për furnizimin e popullsisë me ujë, me të cilin do të kuptohet instalim i impianteve të pompimit dhe pastrimit të ujit, shtrimi i linjave të furnizimit dhe vendosja e aparateve matëse.

f) në shërbimet e natyrës komunale për furnizimin e popullsisë me energji elektrike, me të cilat do të kuptohet instalimi i transformatorëve, shtrirja e rrjetit të furnizimit dhe shpërndarja e vendosja e aparateve matëse.

5. Makineritë dhe pajisjet që kanë fituar lehtësitë e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi,

duhet të regjistrohen në llogarinë e mjeteve themelore të investitorit dhe, për çdo ndryshim të gjendjes së tyre kontabël a fizike, duhet të njoftohen organet doganore dhe tatimore kompetente.

6. Makineritë dhe pajisjet që ndodhen në regjistrin e lejimit të përkohshëm, në qoftë se deklarohen për t'u zhdoganuar për qarkullim të lirë, përfitojnë nga lehtësitë e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, në qoftë se plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara më lart.

7. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimet përkatëse për procedurat që duhet të ndiqen në doganë për të përfituar nga lehtësitë në fjalë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtin efektet nga data 15.5.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Bashkim Fino